

“Mjedisi Sot”
Nr 2185 E Hene 03/09/2007

Pergatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Kati III
Kutia postare 127, Tirane
Tel/Faks (+355 4) 23 29 28
Email: info@albania.rec.org
Web: <http://albania.rec.org>
www.mjedisisot.info

PERMBAJTJA

NGA VENDi

- Ambientalizmi si alternative e sigurte
- Protesta: per tec-in mos pritni pishat
- Turizmi me syte e turisteve
- Flaket na lane pa sezon gjuetie
- Korce, ne greve urie per mbrojtjen e pyjeve
- Burrel, digjen pyjet ne masivin e qafe-shtames
- Durres, porti detar i qytetit mbulohehet nga plehrat
- Viroi turistik, se shpejti pika me e bukur e gjirokastres

NGA BOTA

- Portugalia ndermerr projekte per te perdorur energjine e gjelber
- Papa u ben thirrje te rinjve katolike te frenojne demin ekologjik

Njoftime

- Konsultim publik mbi vleresimin e ndikimit ne mjedis te projektit “menaxhimi i integruar i ekosistemit te liqenit te shkodres”

- Thirrje per projekte ne kuadrin e programit te granteve te vogla
- Konusltime publike mbi planin strategjik te veprimit per llojet migratore
- Earthcorps International Program - International outreach trainer position announcement
- 11th international specialized conference on watershed & river basin management

Te gjitha OJF-te mjedisore dhe ato qe kryejne aktivitete per mjedisin, jane te mirepritura te dergojne informacione ose njoftime, ne adresen 'Mjedisi Sot' info@albania.REC.org, ose Kutia Postare 127, Tirane.

Pergatitja e lajmeve ditore eshte mundesuar ne saje te mbeshtetjes nga Agjencia Spanjolle per Bashkepunim Nderkombetar – AECI.

Nga VENDI

Ambientalizmi si alternative e sigurte
Arben Dulo, gazeta Shekulli, fq. 19

Duke perkrahur ambientalizmin si nje alternative te sigurt zhvillimi, Xhon Makein, kandidati Republikan per President te Amerikes, shpesh here i drejtohet publikut me fjalet: "Imagjinoni si do te ishte Amerika sikur te mbeshtetej ne alternativat ambientaliste edhe sikur efekti sere i ngrohjes globale te mos ishte i vertete." Duke vazhduar fjalimin e tij, ai pershkruan rezultatet ne nje Amerike te zhvilluar mbi alternativa te provuara ambientaliste, duke perfunduar ne fakte qe do te duken qarte. "Amerika do te ishte e pavarur nga shtetet eksportuese te energjise, e konflikteve boterore; Rusia, vendet e Lindjes se Mesme dhe Afrikes Qendrore. Ambienti i paster do te ishte nje faktor plus per nje jete me te lumtur e me te shendetshme per kedo qe do te jetonte ne token Amerikane." Cfare ndodhi ne Shqiperine e dekadave te fund shek te XX-te e ne kete fillim shekulli te ri. Megjithese dukurite negative te prishjes se ambientit jane fakte reale, votuesit dhe politikanet Shqiptare te etur per zgjidhje te shpejta e te lehta, kane lene menjane alternativat ambientaliste ne kerkim te modernitetit teknologjik, e urbanistik. Por a eshte ky modernitet teknologjik e urbanistik, i kerkuar me aq mund, i njejte me ate te vendeve te zhvilluara te Perendimit? Pergjigja eshte; Jo, Jo edhe Jo. Rrugedalja nga kjo mendesi negative zhvillimi qe ka cuar ne katrahurenambientaliste, si edhe ne varesine energjitike nga importi, eshte e thjeshte. Dhenia e shperblimeve per ata sipermarres dhe qytetare qe ruajne ambientin, kursejne energjine dhe investojne ne drejtim te energjive te rinovueshme. Ndeshkime te rrepta financiare per ata qe kerkojne te kunderten. Dikush mund te qeshe me te madhe duke u shprehur se nga e thena ne te bere eshte nje mal i tere. Presidenti Xhorxh Bush nenqeshi keshtu me ironi, kur si President i sapo zgjedhur, pasi shpjegoi veshtiresine e Amerikaneve per te ulur shpenzimin e hidrokarbureve, nje ambasador Evropian i dha zgjidhjen e thjeshte, "Taksim shume here me te larte te hidrokarbureve, te ngjashem me ate qe aplikohet ne shtetet e Bashkimit Evropian." Nje njeri me mendje te kthjellet, qe e njeh realitetin Amerikan, do te mendonte pernjehere pasojat e taksimit te larte ne hidrokarbure, qe do te conte ne rritjen shume here me te madhe te cmimit te tyre, dhe do te miratonte ironine e Presidentit Bush. Zemerimi i votuesve Amerikane per kete rritje cmimesh do teshkaktonte humbje te sigurt ne zgjedhjet e ardhshme Presidenciale te kujtdo qe do te iniciante politika te tilla taksimi e kufizimi. Deshtimi i Xhimi Karterit ne vitet 70-te ne zgjidhjen e krizes energjitike me ane te taksimit/tollonizimit, eshte nje mesim i hidhur per politikanet Amerikane. Por cfare ndodhi pas fillimit te luftes ne Irak? Cmimet e larta te hidrokarbureve ne tregun boteror dhe varesia Amerikane nga (ar)miqte e saj shekullore; Rusia dhe vendet e Lindjes se Mesme beri qe politikanet dhe votuesit Amerikane ta shohin pavaresine energjitike si ceshtje te sigurimit kombetar,

dheambientalizmin si alternative te sigurt te pavaresise energjitike. Presidenti Bush nga beniamin i shoqerive shumekombeshe te naftes eshte kthyer ne nje propagandues te alternativave ambientaliste, duke propozuar reduktimin me 20% te hidrokarbureve per 10 vitet e ardhshme, dhe zevendesimin e tyre me burime alternative si bio-diezel apo burime te tjera ambientaliste (energji diellore, fuqine e erez) ose jo (qymyr, energji nukleare). Nga ana tjeter, shtetet e Evropes Perendimore me politikat e tyre ambientaliste dhe nacionaliste, te zbulimit dhe ruajtjes se burimeve kombetare te energjise, u bene faktorikryesor ne kapercimin e krizes boterore energjitike te viteve 70-te. Gjithashtu ato po behen faktori kryesor ne hartimin e politikave ambientaliste dhe energjetike, mbare boterore ne ditet e sotme. Sigurimi i nevojave energjitike ne masen e 30% nga burime te rinovueshme, dhe 40-50% burime te tjera (qymyr, energji nukleare) i ka bere keto shtete te mos e ndiejne presionin e Rusise ne ate mase qe boset e Kremlinit do te deshironin.

Cfare ndodh ne Shqiperi? Vetem nje njeri i cmendur do te mendonte se ngrohja globale nuk eshte faktor real ne Shqiperi. Politika Shqiptare ne vend qe te nxitonte dhe te vraponte si e marre per te investuar ne energji te rinovueshme (diellore, bio-diezel, fuqine e erez), apo ne teknologji te perparuara ne fushat e naftes dhe perpunimit te saj, fsheh koken ne reren tradicionale te energjise, duke folur me sikur-et e koncesioneve. Qeveria Shqiptare ne vend te kembenguljes ne zhvillimin e politikave te uljes se importit te energjise po kerkon te importoje sa me shume, duke harxhuar qindra milione dollare kesh per importimin e saj. Kjo valute aq e domosdoshme per ekonomine Shqiptare mund te shpenzohej fare mire ne politikat e thjeshta (qe pershkruam me siper) per stimulimin e alternativave te tjera te prodhimit dhe kursimit te energjise.

Le te shpjegohemi edhe ne me gjuhen e politikaneve tane energjitiko-marroke dhe te flasim me sikur-e. Le te imagjinojme se te gjitha TEC-et dhe HEC-et e Shqiperise do te ishin tashme te perfunduar sipas fjaleve te Qeveritareve tane. Le te imagjinojme se ndikimi i tyre mbi ambientin do te ishte minimal, te cilin jo shume (perfshire ketu edhe turistet e ardhshem) mund ta besojne. Cfare do te ndodhte me Shqiperine tone te dashur "turistiko-tregtaro-industriale," ne nje vere te gjate e te thate si kjo e tashmja? Perseri e njejta histori. Ndryshimi. Ashtu si ne kete vere, me lumenj te thare, Shqiperia nuk do te varej nga importi i energjise elektrike, por nga importi i gazit Rus, dhe naftes se shtrenjte ne tregun boteror. Ne nje Shqiperi me lumenj te thare emisaret e jashtem te Qeverive Shqiptare do te udhetonin jo per te mbrojtur interesat mbare kombetare, por per te siguruar pak nafte e pak gaz per TEC-et e tyre te mjere. Kush ka veshe e sy po ndien e po sheh sesi po zhvillohet historia e gazsjellesve ne Ballkanin tone te dashur, i cili nga "fuci baruti," po kthehet ne nje "bombe te krizave energjitike e ekologjike."

Prandaj progresistet e nacionalistet Shqiptare, te tere ata qe duan nje Shqiperi te paster e te pavarur, duhet te ngrene zerin e tyre argumentues ne dobi te alternativave ambientaliste te rinovueshme, si edhe alternativave te tjera kombetare te burimeve energjitike. Keto alternativa jane te ndryshme nga Godote energjitike Qeveritare te HEC-ve e TEC-ve. Keto alternativa mund te duken te pamundura per mendjet e politikaneve te varura nga importi i energjise, nga HEC-et dhe TEC-et, si mendja e te droguarit nga droga. Por ne te vertete ato jane alternativa te sigurta zhvillimi. Dhe me perpara se ata (politikanet) te buzeqeshin triumfalisht ne pritje te Godose se tyre energjitike ne 2020-en, u thoni drejt e ne sy (ne kutine e votimit), "Po sikur te investojme ne burime ambientaliste, dhe alternativa te tjera kombetare te prodhimit e kursimit te energjise, si do te ishte Shqiperia, votuesi dhe qytetari Shqiptar?" Kjo pyetje duhet te behet jo pse HEC-t dhe TEC-et nuk perbejne nje burim te rendesishem dhe kryesor te energjise. Problemi qendron tek ata faktore shtese te alternatives ambientaliste apo i burimeve te tjera kombetare, qe shtetet moderne dhe te pavarura po kerkojne t'i zhvillojne ne menyre qe te garantojne cilesine e jetes se qytetareve, dhe pavaresine politike te tyre. Ne nje bote te zhytur ne krizen energjitike, ku energjia perdoret ne cdo moment si shantazh per te devijuar politikat e pavarura te zhvillimit, faktori ambientalist kthehet ne faktor te sigurise e pavaresise kombetare, kur harmonizohet me burimet e tjera kombetare te energjise.

Ne kete vere me thatesire te zgjatur, ne kete vere te katastrofave ekologjike, me kufizime tragjike te ujit dhe energjise, pergjigja ne dobi te ambientalizmit e burimeve te tjera natyrore do te ishte e qarte per kedo. Ndoshta duke perifrastuar fjalet e kandidatit Republikan per President te Shteteve te Bashkuara te Amerikes mund te thoshim se pas zbatimit te politikave ambientaliste e kombetare te sigurimit te energjise, "Shqiperia do te ishte me e pavarur nga shtetet eksportuese te energjise e konflikteve Ballkanike. Ambienti i pastër do te ishte nje faktor plus per nje jete me te lumtur e me te shendetshme per kedo qe jeton ne territorin e Shqiperise, si dhe per turistet nga ardhja e te cileve ekonomia Shqiptare po varet perditë e me shume."

PROTESTA: PER TEC-IN MOS PRITNI PISHAT

Ornela Hila, gazeta Koha Jone, fq. 22

Aleanca per mbrojtjen e gjirit te Vlores u rikthye dje me nje tjeter proteste, e cila ka pasur ne fokus te saj kembenguljen per mosndertimin e Tec-it ne Vlore dhe veprave te tjera me baze nafte. Aleancistet jane mbledhur fillimisht ne Sheshin e Flamurit per te vijuar me nje varg prej rreth 15 automjetesh dhe tri autobusesh, qe valevisnin flamuj, e mbanin borite takuar ne shenje proteste ndaj Tec-it, qe ka filluar te ndertohet. Ata kane pershkuar rrugen deri ne Triport, ku kane filluar punimet per hapjen e kantierit dhe prerjen e pishave, per te bere aty nje tubim paqesor. Kreu i Aleances, Gani Mezini, dhe perfaqesues te tjere te saj, si dhe shume qytetare jane bashkuar ne kerkesat per te mos vijuar prerja e pishave. "Asnje pishe nuk duhet te lejohet qe te prihet, - thane aleancistet, kjo eshte nje shkelje flagrante".

Sipas ligjit, pishat duhet te ishin mbjelle tre muaj me pare dhe ne nje sasi trefish nga keto qe po priten dhe jo te priten e mos te mbillen. Mezini ka permendur dhe konventen e Anhrusit, nenin 6 te saj, i cili eshte shkelur, qendrimin e ndryshuar karshi ketij investimi nga Banka Boterore, "e te tjera te drejta, te cilat i jane shkelur qytetareve te Vlores me lejen e dhene te ketij investimi". Sipas aleancisteve, nuk do te lejohet nga ana e tyre prerja e asnje peme me teper, dhe gjithashtu ata i kane kerkuar firmes, qe po ndjek punimet, te heqe makinerite nga zona. Pasi jane ndalur per disa minuta ne vendin ku po ndertohet Tec-i, ata jane perqendruar ne vendin ku do te ndertohet Petrolifera, duke denoncuar publikisht punimet e nisura, qe behen gjate nates. Keto jane afere te pista te politikës se ketyre viteve, te te dyja qeverive. Ne kerkojme qe te nderpriten punimet dhe te pyetet komuniteti i Vlores, thane ata duke vijuar: "Mire Tec-i qe do te sjelle drita, po nafta cfare do t'i sjelle Vlores?!" Shume flamuj e banderola me slogane si, "Jo Tec-it, Petroliferes dhe Ambos!" mbaheshin ne duar nga qytetaret dhe aleancistet e pranishem ne tubimin paqesor, i cili gjate gjithë kohës eshte ndjekur nga efektive te shumte policie. Aleancistet deklaruan gjithashtu se cdo te diel do te kete te tilla tubime me pikenisje Sheshin e Flamurit dhe perqendrim me pas ne zonen ku po priten pishat per te hapur kantierin e ndertimit te Tec-it. Ata i kane bere thirrje qeverise dhe pushtetit vendor te rishikoje vendimet e marra per keto vepra energjetike dhe sidomos ato me baze nafte, ndersa kane kerkuar mbeshtetjen e qytetareve per kerkesen e tyre per referendum, sikunder eshte planifikuar ne Burgas te Bullgarise per t'u zhvilluar referendumi per lejimin ose jo te ndertimit te veprave me baze nafte atje.

Turizmi me syte e turisteve

Romeo Hanxhari, gazeta Shekulli, fq. 19

Tani, ne kete mes gushti, me vijne ne mend dhe dua te ndaj me te gjithë aktoret e interesuar disa eksperienca te kesaj periudhe te sezonit te kaluar turistik me miq e kolege te huaj, ...qe per statistikat quhen "turiste". Secila nga keto 3 perva te ndryshme ka te beje me sjelljen dhe performancen e

secilit prej tre aktoreve baze te nje Sistemi Turistik: strukturat shteterore, operatoret turistike private dhe komuniteti lokal ose publiku ne pergjithesi. Te tre keta aktore duhet te kuptojne se sukcesi i turizmit ne Shqiperi nuk do te jete i mundur nese sikur edhe njeri prej tyre nuk i mban pergjegjesite qe i takojne, per ta konsideruar turizmin si “nje investim per te ardhmen” dhe jo si nje “qar te se sotmes”. Ajo cka secili prej tyre ben, dhe menyra sesi secili prej tyre vepron, ben qe turisti ose te rikthehet serish bashke me dhjetera te tjere tek te cilet do te shkojne pershtypjet e tij, ose te mos rikthehet me kurre, duke i larguar ata dhjetera turiste potenciale pergjithmone.

Pra ajo cka turisti mendon per ty ne fund te qendrimit te tij, kushtezon te ardhmen e turizmit. Kjo ka qene arsyeja pse kam menduar gjithmone se nese strukturat e politikave dhe promocionit turistik do te donin te kishin nje analize te plote SWOT te performances se sektorit turistik, te pakten per te njohur dobesite e sistemit, do te duhej te benin nje vrojtim “ne tapet” me turistet e huaj ne hyrje dhe ne dalje nga Shqiperia. Do te shikonin ashtu se cfare vleresojne dhe cfare refuzojne fort ata nga vendi dhe njerezit tane, duke identifikuar konkretisht ku dhe si duhet nderhyre. Mesa di une, askush s’eshte kujtuar ta beje nje kerkim te tille. Ua ofroj me deshire kete ide, dhe i ftoj ta zbatojne... Hollesirat gjenden.

Por rastesisht dhe pa dashje, ne miniatyre kete gje e bera une vjet, kur gjate gushtit pata mysafire kolege te ndryshem nga Italia ne disa momente. Ne fakt, kjo tregon edhe se praktikimi i “turizmit ne Shqiperi” nuk eshte me edhe aq jashte te zakonshmes. Te huajt kane filluar te vijne. Kete e shikoj edhe nga nje interesim gjithmone e me i madh per te ardhur per here te pare ne Shqiperi. Prandaj ketu do te bej nje paranteze te shkurter. Sa here qe me qellon te shkoj ne nje Universitet italian me te cilin me lidh puna, ka gjithmone e me shume kolege apo teknike, apo edhe studente qe kerkojne te sigurohen te vijne ne Shqiperi. Natyrisht gjithmone ndihem mire, dhe e bej me shume kenaqesi kur i ndihmoj te bejne itinerare te pershtatshme per interesat e tyre kulturore. Sepse eshte themelore qe te vijne turiste, por eshte edhe me e rendesishme qe te kthehen serish: dhe kjo e dyta eshte misioni me i veshtire i turizmit dhe aktoreve te tij. Perpara rreth nje viti organizova me kerkesen e tyre, nje udhetim “rikonjicioni” te 40 kolegeve profesore dhe studente PHD te Universiteteve italiane. Kete vit nje pjese e mire e tyre kerkuan te kthehen serish sapo te plotesojne numrin e nje grupi. Dhe nje pjese e te rinjve te grupit do te vijne edhe spontanisht. Kjo do te thote dicka, ...por jo gjithcka...

Pra c’te bejme? Ndoshta kjo eshte Shqiperia,... dhe pike? Ndoshta. Por une s’di pse besoj se ne mundemi te ndryshojme dicka. Mund te fillojme se pari duke kuptuar qe imazhin e Shqiperise tek turisti e ndertojme te gjithë ne, dhe jo vetem Ministria, e as vetem biznesi, apo vetem komuniteti. Ama, te gjithë bashke po. Duke bere secili me qytetari ate pjese qe na takon. Fjala vjen, nga keto me lart le te nxjerre secili pjesen e vet te fajit dhe pjesen e vet te reagimit. Vetem keshtu dicka do te levize per mire. Ndryshe, ndonje turist edhe do te vije,... por ndoshta s’do te kthehet me serish.

Flaket na lane pa sezon gjuetie
B. Kore, gazeta Koha Jone, fq. 6

Sezoni i gjuetise ne qarkun e Gjirokastrës duket se do te jete nje zhgenjim i vertete per gjahtaret e Jugut, si shkak i zjarreve te shumta, qe perfshine pyjet gjate kesaj vere te nxehte dhe demet qe kane shkaktuar ato ne ekosistemin natyror dhe ambiental. Flaket kane shkruar me dhjetera gjallesa dhe kafshe te egra duke sjelle keshtu demtime te pariparueshme ne faunen e Jugut. “Ne vazhdimisht kemi ngritur zerin ne lidhje me demtimet qe kane shkaktuar zjarret tek kafshet e egra dhe gjallesat e tjera, qe rriten ne pyjet e Jugut”, tha dje kryetari i Shoqates se Gjahtareve Sportive ne Gjirokastrë, Stefan Qurku. Sipas informacioneve qe disponon kjo shoqate, zjarret kane shkruar me dhjetera specie dhe gjallesa ne siperfaqet pyjore dhe kullosore. “Se bashku me demtimin e pyjeve,- vijon Qurku,- flaket kane sjelle demtime edhe per gjallesat dhe ekosistemin e ketyre zonave”. Ne harten e

zjarreve, te publikuara disa dite me pare nga policia e Gjirokastrës, perفشihen edhe zona mjaft te preferuara nga gjahtaret sportive. Gjate kesaj vere nen flake ka qene pylli i Sotires, ai i Prongjise, siperfaqet pyjore ne zonen e Dropullit, Malit te Gjere etj, thote Qurku duke numeruar zonat, te cilat nuk do te figurojne ne guiden e ketij sezoni gjuetie. "Ky do te jete sezoni me i varfer i gjuetise ne keto vitet e fundit", thekson Qurku. Gjate levizjes se tyre ne masivet e shkrumbuara te pyjeve gjahtaret kane gjetur dhjetëra shpende dhe kafshe te egra, te shkrumbuara nga zjarri. Nderkohe, Shoqata e Gjahtareve gjirokastrite gjate ketij sezoni me zjarre te shumte eshte bere pjese e fushatave sensibilizuese te opinionit publik ne lidhje me ruajtjen dhe miremenaxhimin e siperfaqeve pyjore. "Te 400 anetaret e shoqates kane qene pjese e mbrojtjes se siperfaqeve pyjore dhe kullosore gjate kesaj stine te nxehte", deklaroi kryetari Qurku. Ne disa raste kane qene anetaret e Shoqates se Gjuetareve, te cilet kane dhene sinjalet e para ne lidhje me vatrat e zjarrit, qe perfshine pyjet e Jugut. Sipas tyre, demet qe kane shkaktuar zjarret e kesaj vere te nxehte ne ekosistemin natyror do te duhen vite qe te zevendesohen duke sjelle keshtu nje varferim te llojeve te bimesise dhe gjallesave ne Jug te vendit.

Korce, ne greve urie per mbrojtjen e pyjeve
A.Grabocka, gazeta Shekulli, fq. 8

Shkaterrimi me zjarr i pyjeve ne zonen ku eshte rritur dhe mosvenia para pergjegjesise e autoreve kane bere qe nje 65-vjecar nga Strelca e Korces te hyje ne greve urie. Nje greve, qe tingellon cuditshem ne ditet e sotme, kur duket mungoje ata qe ende vrasin mendjen per pasurine e perbashket.

Greva
Reiz Petriti, nga fshati Strelce i komunes se Gores, ne rrethin e Korces ka vendosur te hyje ne greve urie prane mjediseve te godines se komunes. Ashtu si thote ai vete, qellimi eshte te sensibilizojë gjithë instancat dhe komunitetin ku ai ben pjese qe te ndergjegjesohen per mbrojtjen e pyjeve nga zjarret ne zonen e tij. Njeheresh ai jep alarmin se pyjet e fshatit Strelce jane shkaterruar prej vitesh dhe subjektet apo personat qe kane ushtruar aktivitetin e tyre te shfrytezimit te drurit per te fshehur demin e llogaritur do t'i vene zjarrin pyllit. "Edhe pse ne pyjet e ketij fshati qe prej 1 viti eshte vendosur nga drejtoria e sherbimit pyjor qe te pezullohet cdo aktivitet, vetem naten e mbremshme kam numeruar 10 automjete te renda te ngarkuara me dru zjarri dhe lende",- tregon ai.

Apeli
Per kete katastrofe ekologjike ai thote se ka njoftuar gjithandej, por askush nuk ka levizur as gishtin per te marre masa. "Vendosa te hyj ne greve urie, sipas te gjitha rregullave, ku kam njoftuar edhe policine me qellim qe ne rast se nga sepata u pre nje siperfaqe e konsiderueshme druresh pyjor, te shpetoj te pakten ate pasuri kombetare qe ka mbetur nga zjarret",- thote grevisti. Keqberesit, sipas tij, jo vetem qe e kane masakruar pyllin, por tani nuk po kursejne as flaket. Sipas tij, gjate viteve te fundit eshte shkaterruar edhe druri i robullit te kuq, i cili eshte ndaluar ne menyre kategorike te pritët.

Sherbimi pyjor
Nderkohe ne lidhje me shqetesimin e te parit grevist qe ngujohet per pyjet, vete drejtori i sherbimit pyjor, Korce, shprehet se gjate nates se te premtes, pas nje kontrolli te befasishem, jane kapur 3 kontrabandiste, qe perfitonin nga kjo situatë duke vene dore ne druret pyjore te Strelces. "Per ta do te veprohet sipas dispozitave ligjore",- thote drejtori i pyjores. Por pavaresisht kesaj, Reiz Petriti eshte i vendosur te vijoje greven e urise, deri ne marrjen e masave te plota per ruajtjen e pyjeve nga shkaterrimi i tyre

Zjarret kane mesyer masivet pyjore ne rrethin e Matit. Dje jane perfshire nga flaket pyjet e larta ne vargmalet Skenderbeg dhe ato te Qafe Shtames.

Drejtoria e Sherbimit Pyjor beri te ditur se per shkak te flakeve te zjarrit jane demtuar nje sasi e madhe pyjesh me pishe, ah, bredh e dushqe. Tymi e flaket e zjarrit kane pushtuar gjithe zonen, nga Shkopeti e deri ne komunen e Gurres. Qindra hektare jane pershkuar nga zjarri dhe dhjetera hektare me pyje te larte jane djegur. Drejtori i Sherbimit Pyjor Mat, Skender Lata tha se inspektoret e pyjeve ne keto zona kishin evidentuar persona qe u vinin zjarrin pyjeve. Njoftuam menjehere policine lokale, tha Lata. Shume shpejt ne Madhesh mberriten forcat e grupit te gatshem dhe bene te mundur ndalimin e 5 personave te evidentuar si zjarrvenes. Nderkohe mesohet se 4 nga personat e ndaluar do te ndiqen ne gjendje te lire dhe vetem njeri nga te akuzuarit, Leke Vokrri do te ndiqet penalisht ne gjendje arresti me burg. Drejtoria rajonale e policise Diber njoftoi se prioritet te punes se saj ka evidentimin dhe ndalimin e personave qe shkaktojne zjarre ne menyre te qellimshme.

Durres, Porti detar i qytetit mbulohet nga plehrat
News 24

Vetem 200-300 metra larg qendres se Durresit ne kufi me portin detar ndodhet nje varreze hekurudhore dhe nje shesh ne te cilen jane depozituar mbeturina si dhe jane gritur disa objekte pa leje ne formen e barrakave. Behet fjale per ne lagjen 4 te qytetit te Durresit, banoret e se ciles jane ankuar disa here ne institucionet perkatese si te pushtetit vendor por edhe atyre te hekurudhes. Per kete situatë nenbashkite bejne pergjegjese hekurudhen pasi ajo eshte territor ne pronesi te saj e qe duhet te nderhyje per permiresimin e gjendjes.

Kjo zone behet edhe me problematike mbremjeve kur shikon njerez te dehur apo perdorues te lendeve narkotike te cilet krijojne shqetesim per banoret e atij blloku. Ne hekurudhe thone se kane shpallur tender per copetimin e vagoneve te trenit per skrap por realizimi i i tij po mungon. Nga ana tjeter ne policine ndertimore nuk eshte depozituar asnje kerkese per prishjen e objekteve pa leje dhe largimin e mbetjeve inerte. Ne baze te nje projekti te perbashket ndermjet hekurudhes dhe portit detar eshte parashikuar qe kjo siperfaqe toke rreth 20 mije meter katror do ti kaloje ne pronesi portit te Durresit per zgjerimin e kufirit te tij. Ky eshte nje projekt i krijuar nga banka boterore por qe ende nuk po gjen zgjidhje nga institucionet pergjegjese.

Viroi Turistik, se shpejti pika me e bukur e Gjirokastrës
Gerti Xhaja, Gazeta Shqiptare, fq. 13

Bashkia e Gjirokastrës ne bashkepunim me rajonin e Markeve ne Itali, perfundon projektin “Viroi Turistik”, nje projekt ky qe do t'i jape nje fizionomi te re pikes me te bukur te qytetit te Gjirokastrës, dhe do ta beje ate funksionale ne sherbim te qytetareve. Sipas projektit te pergatitur me perkushtim e profesionalizem nga specialistet dypalesh, Viroi do te shnderrohet ne nje mjedis clodhes, pushues dhe argetues per banoret e Gjirokastrës dhe trevave perreth. Kryetari i Bashkise se qytetit te Gjirokastrës, Flamur Bime tha se sipas projektit jane parashikuar 2 milione dollare per piken turistike te Viroit, shume kjo e mjaftueshme per ta kthyer Viroin ne nje qender te madhe pushimi per qytetaret. Kryebashkiaku i qytetit te gurte tha se ne projekt jane parashikuar rruge dhe trotuare pergjate bregut te liqenit, ndricim modern dhe bashkekohor, si dhe lulishte apo edhe parqe te vogla. E gjithë pjesa e

zhveshur ne afersi te liqenit do te pyllezohet, ndersa tregtia ambulante do te marre zhvillim dhe do te mbeshtetet nga Bashkia e qytetit. Ne projekt parashikohet edhe rritja e lartesis se prites se liqenit, me qellim qe uji te grumbullohet dhe te mos largohet drejt shtratit te lumit Drino. Menjehere pas perfundimit te projektit, Bashkia e qytetit dhe stafi i caktuar per ndryshimin progresist te Viroit, eshte vene ne kerkim te donatoreve te huaj dhe vendas, per te siguruar financat per zbatimin ne praktike te tij.

NGA BOTA

Portugalia ndermerr projekte per te perdorur energjine e gjelber

Shqetesimet per ndryshimet klimatike kane shtuar interesimin per burimet energjetike te riproteritshme, per te pakesuar sasine e gazeve karbonike qe clirohen ne atmosfere dhe qe konsiderohen si shkaktaret kryesore te ngrohjes globale. Bashkimi Evropian shpreson te pakesoje ne masen 20 % clirimin e ketyre gazeve brenda vitit 2020. Keto angazhime qe degjohen me te madhe ne selite e qeverive evropiane sot, kane marre nje forme konkrete ne Portugali, ku autoritetet po vene ne prove nje numer projektesh ambicioze per te ashtuquajturen "energji te gjelber."

Portugalia eshte e famshme per plazhet me diell dhe vererat e nxehta, por tani ky vend shpreson te marre emer si udheheqes ne perpjekjet boterore per energji te riproteritshme. Qeveria shpreson te perfitoje nga klima e pershtatshme per te shfrytezuar energjine diellore dhe ate te eres. Ne periferi te kryeqytetit, Lisbone, jane vene ne perdorim komplekse te medha per te gjeneruar energji nga era. Zhoakim Pina Moura, ministri portugez i Ekonomise, thote se vendi shpreson te nxise shfrytezimin e energjise se riproteritshme dhe te ule varesine nga hibrokARBURET qe importohen:

"Kemi nje detyre te madhe perpara, gjate kohes kur Portugalia mban Presidencen e Bashkimit Evropian, ne duhet te eksportojme idene e nevojtes per te rritur mbeshtetjen tek burimet e riproteritshme. Jemi shume te shqetesuar per ngrohjen globale dhe duam gjithashtu te ulim varesine tek energjia e importuar, jo vetem ne vendin tone por ne mbare kontinentin, prandaj i kemi varur shpresat tek burimet e riproteritshme".

Qyteti Serpa, ne rajonin jugor Alentejo, eshte prove e zhvendosjes se vemendjes se qeverise nga burimet tradicionale ne burimet e energjise se gjelber.

Piero dal Maso drejton operacionet teknike ne centralin me te madh diellor ne bote, i cili u perfundua kete vit. Ai thote se centrali eshte ne gjendje te permbushje nevojat e mbi 8 mije banesave dhe pakeson dioksidin e karbonit te cliruar ne atmosfere ne masen 2 mije tone ne vit. Dal Maso thote se centrali i Serpas ka 52,000 panele diellore ne nje sipërfaqe prej 60 hektarësh dhe gjeneron 11 megavate energji.

Pjesa me e madhe e centraleve diellore prodhojne vetem 1 apo 2 megavate, por ky projekt shfrytezon ne menyre optimale kushtet e mrekullueshme klimatike te Portugalise.

Banoret e fshatit ndjehen krenare per rolin qe ka marre komuniteti i tyre ne luften kunder ndryshimeve klimatike. "Njerezit nga Alentejo te duken si te dale mode, por perkundrazi. Ne e dime qe centrali diellor nuk na demton, nuk shkakton ndotje. Prandaj fshati e ka pritur shume mire, pasi ka krijuar edhe nje numer vendesh pune", thote njeri prej tyre.

Nje nder organizatat nderkombetare qe po perpiqen te nxisin perdorimin e enrgjise se gjelber eshte Quercus. Kreu i kesaj organizate eshte Francisco Fraga. "Aktualisht jemi angazhuar ne nje fushate per te nxitur perdorimin efikas te energjise. Keto perpjekje jane tani perparesi jo vetem per Portugaline, por per gjithë Bashkimin Evropian, i cili synon qe brenda vitit 2020 te rrisë ne masen 20 per qind efikasitetin e gjenerimit, shperndarjes dhe konsumit te energjise".

Sipas statistikave zyrtare te publikuara nga BE-ja, Evropa mbeshtetet ne masen 80 per qind ne

energji te importuar per te plotesuar nevojat e saj. Portugalia synon qe deri ne vitin 2010 burimet e ripreteritshme te perfaqesojne 39-45 per qind te totalit te energjise qe shfrytezon vendi. Me nje politike te tille, ky vend shpreson te luaje nje rol kyc ne Konventen e OKB-se per Klimen qe zhvillohet ne dhjetor ne Bali, ku udheheqesit boterore do te diskutojne nje marreveshje globale qe te pasoje Traktatin e Kiotos mbi ndryshimet klimatike dhe clirimin e gazeve ndotese.

Per me shume informacion:

<http://www.voanews.com/albanian/2007-09-02-voa4.cfm>

Papa u ben thirrje te rinjve katolike te frenojne demin ekologjik

Papa Benedikti u beri thirrje qindra mijera besimtareve te rinj katolike qe te kujdesen me shume per planetin dhe te frenojne demin ekologjik. Papa e lexoi mesazhin e tij ne mbrojtje te mjedisit gjate nje meshe te hapur ne ditën e dyte te nje ceremonie fetare ne Loreto te Italise.

Ai u tha besimtareve se nga ata do te varej shpetimi i planetit nga zhvillimet, te cilat shpesh nuk perfillin "ekulibrin delikat te natyres", sic e quajti ai. Papa 80 vjecar, gjithashtu, tha se alternativat e guximshme te cilat mund te krijojne nje aleance te forte mes njeriut dhe tokes, duhet te realizohen perpara se te jete teper vone. Rreth 500 mije njerez moren pjese ne meshen e mbajtur nga Papa.

Per me shume informacion:

<http://www.voanews.com/albanian/2007-09-02-voa5.cfm>

Njoftime

Konsultim publik mbi vleresimin e ndikimit ne mjedis te projektit "menaxhimi i integruar i ekosistemit te liqenit te shkodres"

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, permes Njesise se Menaxhimit te Projektit "Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit te Liqenit te Shkodres" ne kuader te hartimit perfundimtar te ketij Projekti, kerkon mendimin e institucioneve, publikut te interesuar dhe te Organizatave Jofitimpruese mjedisore per studimin mbi Kornizen e Projektit.

Studimin ne gjuhen Shqipe dhe Angleze mund ta gjeni ne adresen e meposhtme:

Njesia e Menaxhimit te Projektit «Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit te Liqenit te Shkodres»

Godina e Prefektures Shkoder

Kati i Dyte

Jeni te lutur per komente dhe sygjerime, te cilat mund te dergohen brenda **dates 10 Shtator 2007** ne adresen e mesiperme ose ne adresen e emailit: a_shimaj@yahoo.com

Thirrje per projekte ne kuadrin e programit te granteve te vogla
LAJMERIM I FONDACIONIT SOROS

Programi i Granteve te Vogla prane Fondacionit Soros mundeson zhvillimin e bashkepunimit ndermjet grupeve te ndryshme te komunitetit, nxit dhe promovon dialogun per probleme te ndryshme qe shqetesojne shoqerine shqiptare, ofron mbeshtetje per fuqizimin e grupeve vulnerable, vecanerisht

grave dhe femijeve; ndihmon ne permiresimin e gjendjes se minoriteteve, me perparesi komunitetin Rom, etj.

Kjo thirrje synon te mbledhe propozime per projekte ne drejtimet e meposhtme:

- Permiresimi i gjendjes se komuniteteve, vecanerisht te shtresave vulnerabel dhe te margjinalizuarve, si dhe te minoriteteve etnike e kulturore me perparesi minoritetin Rom;
- Fuqizimi i komuniteteve te grave dhe te rinjve per te rritur pjesemarrjen ne qeverisje dhe ne jeten ekonomike dhe sociale te vendit;
- Monitorim i praktikave te qeverisjes dhe gjallerim i debatit publik per probleme sociale qe interesojne qytetaret;
- Rritja e aksesit te qytetareve ne informacionin e institucioneve publike;

Ne kete program jane te ftuar te aplikojne organizata jo-qeveritare qe punojne me komunitetin, grupe pune dhe institucione/organizma qe kane per mision punen me keto grupe/shtresa te shoqerise. Shuma e financuar do te jete deri ne 7500\$. Ky informacion si dhe formulari i aplikimit (se bashku me listen e dokumentave shoqeruese) jane vendosur edhe ne faqen e internetit: www.soros.al.

Te interesuarit mund ta marrin formularin e aplikimit on-line, apo te paraqiten prane sekretarise se Fondacionit Soros.

Forma e aplikimit dhe dokumentat e tjera te nevojshme duhet te dorezohen prane Zyres se OSFA ne adrese te Programit te Granteve te Vogla **deri me 10 shtator 2007 brenda ores 15:00** ne adresen e meposhtme. Se bashku me dokumentacionin shkresor duhet te dorezohet edhe nje kopje elektronike e projektit (me e-mail ne adresen bskendo@osfa.soros.al, diskete apo USB/CD). Aplikimet me mangesi ne dokumentacion dhe ato qe nuk do te paraqiten ne formen e kerkuar do te skualifikohen automatikisht.

Fondacioni Shoqeria e Hapur per Shqiperine
(Fondacioni Soros)
Rruga "Pjeter Bogdani", Nr.23
Tel:34621/34223/35856
Fax: 35855

KONSULTIME PUBLIKE MBI Planin Strategjik te veprimit PER LLOJET MIGRATORE

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, ne kuader te detyrimeve qe rrjedhin nga ratifikimi i Marreveshjes Afrikane-Euroaziatike per Ruajtjen e Shpendeve te Ujit (AEWA) – nje marreveshje ne kuadrin e Konventes se Bonit "Per llojet migratore" (CMS), kerkon mendimin e publikut te interesuar dhe te Organizatave Jofitimruese mjedisore per Planin Strategjik te veprimit 2009-2017, i cili eshte derguar per mendim nga Sekretariati i Marreveshjes.

Jeni te lutur per komente dhe sygjerime, te cilat mund te dergohen brenda dates **14 Shtator 2007** ne adrese te Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave – Drejtoria e Politikave te Mbrojtjes se Natyres - Zamir DEDEJ zdedej@moe.gov.al

Draft Strategjine e plote mund ta gjeni ne faqen e REC Shqiperi, ne rubriken Njoftime: <http://albania.rec.org/AplikimeNjoftime.html>

EarthCorps International Program - International Outreach Trainee Position Announcement

Position description

The International Outreach Trainee position is a training level, seasonal position in EarthCorps. EarthCorps provides environmental restoration training to emerging leaders, along with leadership training, community service and multicultural understanding of local and global issues. The Outreach Trainee's two primary responsibilities are to facilitate field projects for community and agency partners within the EarthCorps Outreach division and to gather and develop materials to start or support an environmental outreach program in his/her home country. This position reports to the Outreach Program Manager.

Duties and responsibilities

Professional Networking and Workshops:

- Participates in structured series of field, workshop, and classroom trainings. Training will focus on ecological restoration and stewardship, environmental education and youth leadership development.

Youth and Community Outreach Projects:

- Community events at various sites in the Seattle area & special Earth Month events in April.

International Project:

- Writes Individual project proposal in conjunction with sponsored NGO.
- Researches and carries out fundraising opportunities to support project.

Program Support & Administrative:

- Assists other EarthCorps programs/staff as assigned.
- Attends all required staff meetings.
- Completes necessary paperwork in a timely manner. (Training logs, timesheets, etc).
- Prepares oral and written reports of training projects, equipment use and maintenance, project reports and incident reports.

Project Implementation:

- Develops and implements outreach programming and field projects in conjunction with field staff, as well as with community and government agencies.
- Facilitates restoration-based service-learning programs.
- Trains volunteers in environmental restoration techniques.

Training Supervision:

- Maintains appropriate standards of behavior, policies and procedures of EarthCorps.
- Provides leadership and direction in support of program goals and mission.
- Assists in counseling, motivation and discipline of individual program participants.

Communication:

Supports efforts of EarthCorps.

Promotes the health and well being of EarthCorps, staff and corpsmembers in all communications.

Resolves issues/concerns directly with EC staff/corps members or that person's supervisor.

Outreach trainee's terms of service

Status: Volunteer, temporary

Period of training: mid January, - mid December, 2008

Stipend: \$360 / month

Hours of training: 7:30 am – 5:00 pm Mon-Fri; approx. every other Friday off

3-4 multi-day program retreats outside of Seattle throughout program

Possible camping for 2-3 weeks of program

Benefits:

Travel Insurance premium paid for volunteer only.

Bus passes provided during term of service

Airfare to and from Seattle may be partially paid by EarthCorps

Homestay family in Seattle (provides a private bedroom and meals)

Boots, pant, T-shirt and rain gear provided

Required qualifications

5 years practical experience in the environmental field

-Or-

4 years post secondary education, plus one year of work experience in a field related to the environment.

- Interest in environmental fieldwork, intercultural knowledge and educational activities
- Commitment to teamwork with peers from around the world
- Desire to engage in service learning
- Support from a sponsoring organization
- Conversational English
- No Criminal Record

To apply

Candidates should be referred to EarthCorps by an environmental organization (i.e. NGO, LGU, community group or student club).

Materials are available online at: http://www.earthcorps.org/join_international.php.

Application materials will be sent for the candidate upon confirmation of the referring organization.

Referring organizations should have completed the Partner Application Form and send the Candidate Nomination to: mark@earthcorps.org

Deadlines and start dates:

- Application Deadline: **September 21, 2007**
- Participant selection: **October 2007**
- Visa processing: October 2007 - December 2007
- Travel confirmation: January 4, 2008
- EarthCorps Program starting date: mid-January 2008
- EarthCorps Program graduation: mid-December 2008

11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management

The International Water Association is going to organize 11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management on 4-5 September 2008 in Budapest.

The Call for Papers in electronic form (CfPe) which gives a summary of the most important information about the conference can be found on: www.iwa2008budapest.org

Water is a challenge for the century.

Exploring the sustainability of our most valuable resource is our business. IWA presents a unique opportunity to engage in 2 days of innovative discussion on the subjects of Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls and Monitoring and Modelling.

Join other experts in exchanging ideas and exploring networking opportunities during the IWA Watershed and River Basin Management Conference, 4-5 September 2008 in beautiful Budapest, Hungary. Mark this event on your calendar and begin to plan abstract / paper / poster today.

Topics of the Conference:

Include but are not limited to Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls, Monitoring and Modelling.

- River basin management planning under the EU Water Framework Directive;
- River basin management practices in different continents;
- Managing water resources in transboundary river basins with conflicting demand;
- Managing competing uses to protect water quality and quantity;
- Watershed management methods to facilitate water availability for aquatic ecosystem health and human uses;
- Interconnecting sub-watersheds to achieve basin goals;
- Hierarchical approaches to river basin management.
- Monitoring, ecological classification in EU countries and intercalibration;
- State-of-the-art in assessing water and biological quality and integrating data.;
- Programme of measures and ecological state.
- River basin management, advanced computation and decision support;
- The impact of climate change on watersheds, river basins, estuaries and reservoirs;
- Flood control and prevention.
- Effective methods to involve stakeholders and the public into the river basin management planning processes;
- Conflicts and multi-objective management – is it mostly methodology?
- Economics of River Basin Management.

The internet site of the conference is already open (www.iwa2008budapest.org) and interested candidates could submit abstracts under the Registration menu.

The abstract submission period is open until the end of September 2007.

C'eshte "Mjedisi Sot"

"Mjedisi Sot" eshte nje nga botimet periodike te Qendres Rajonale te Mjedisit - Zyra ne Shqiperi. Ne kete botim ditor do te gjeni lajme dhe probleme mjedisore nga shtypi i dites, informacion per aktivitetet mjedisore nga vendi dhe bota.

Per t'u futur falas ne listen e shperndarjes se "Mjedisi Sot" ose per t'u cregjistruar, dergoni nje e-mail ne adresen: info@albania.REC.org

Versionin e shtypur mujor te "Mjedisi Sot" mund ta gjeni prane Zyres se REC ne Shqiperi.

Lajmet mjedisore ditore dhe "Mjedisi Sot" mujor mund t'i gjeni edhe ne internet: <http://albania.REC.org>
www.mjedisosot.info

C'eshte REC

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) per Evropen Qendrore e Lindore eshte nje organizate nderkombetare jopartizane, joavokate, jofitimpruese qe mbeshtet zgjidhjen e problemeve mjedisore ne Evropen Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkepunimin ndermjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktoreve te tjere mjedisore, si dhe duke mbeshtetur shkembimin e lire te informacionit dhe pjesemarrjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

REC eshte krijuar ne 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjerisht ne Karten e tij, nenshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe ne nje marreveshje nderkombetare me qeverine hungareze. REC ka zyren qendrore ne Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve ne secilin prej 16 vendeve perfituese. Shqiperia e ka nenshkruar Karten e REC ne 1992. Zyra e REC per Shqiperine eshte hapur ne 1994. Kjo zyre punon per realizimin e misionit te REC duke mbeshtetur organizatat jofitimpruese, institucionet mjedisore ne te gjitha nivelet, dhe aktore te tjere te interesuar ne fushen e mjedisit, duke mbeshtetur proceset pjesemarrese dhe shkembimin e lire te informacionit. Fushat kryesore te veprimtarise jane: Programi i granteve per OJF-te; Planet Lokale te Veprimit ne Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit per OJF-te dhe zyrtare te mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

Nese jeni te interesuar te njiheni me cfare ndodh cdo dite ne mjedisin shqiptar dhe neper bote, abonohuni falas ne "Mjedisi Sot", pakete e perditshme elektronike. Dergoni nje mesazh me titull "Abonim" tek info@albania.rec.org
